



Datë: 27.02.2025

Numër protokolli:2055/2025

A.nr.133/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyll Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.133/2025, të datës 17.01.2025, të parashtruar nga ankuesi D.K., kundër organit të punësimit: Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.133/2025, e datës 17.01.2025, e parashtruar nga ankuesi D.K.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 16.01.2025 i Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me përfundimin e procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016174, për grupin e administrimit të përgjithshëm, pozita Zyrtar të Trajnimit në KKZ në Prizren, si dhe njoftimi i datës 14.01.2025, i Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, hidhur me refuzimin e aplikacionit të ankuesit.

A r s y e t i m

Ankuesi D.K. (*më tej referuar vetëm: Ankuesi*), më datë 17.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 14.01.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për refuzimin e aplikacionit lidhur me konkursin me numër reference RN00016174, për grupin e administrimit të përgjithshëm, pozita Zyrtar të Trajnimit në KKZ në Prizren.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 20.01.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ndërsa, ky i fundit, më datë 27.02.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 345/2025 të datës 17.01.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër Reference RN00016174, për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Zyrtar të Trajnimit në KKZ në Prizren; Kopjen e ID-së së ankuesit; Njoftimin e datës 14.01.2025; Diplomën me Nr. 5679; Certifikatën nga IKT; Pasqyrën e trustit për periudhën 16.09.2013-10.01.2025; Referencës e datës 08.07.2024 nga GNTC; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 20.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 27.02.2025; Njoftimin për përfundimin e procedurës i datës 16.01.2025; Listën e aplikantëve; Vendimin e datës 26.12.2024 për emërimin e Komisionit të Pranimit; Njoftimin e datës 14.01.2025 për verifikim paraprak; Certifikatën e datës 08.07.2024 të lëshuar nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës/ Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstaton se ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës del se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 24.12.2024 ,ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00016175, Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, pozita “Zyrtar i Trajnimit në KKZ në Prizren”, për realizimin e një projekti me afat të caktuar, 13 vende, me afat aplikimi nga data 24.12.2024 deri me datë 30.12.2024. Tutje, ankuesit si kandidat aplikues në këtë konkurs, më Njoftimin e datës 14.01.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk ka bashkangjitur dëshmi të punësimit, që vërtetojnë përvojën e punës prej një viti.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se ka përvojën e punës së kërkuar dhe nuk qëndron fare arsyetimin se nuk ka dorëzuar dëshmitë e punësimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më datë 27.02.2025, në përgjigjen në ankesë deklaroi se konkursi me numër të referencës RN00016175, ka qenë me kohë të caktuar respektivisht vetëm për Zgjedhjet e Përgjithshme të datës 09.02.2025, dhe kontratat e personave të angazhuar përfundojnë më datë 28.02.2025.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i aktit të shpalljes së konkursit me numër të referencës RN00016174, ka gjetur se konkursi përkatës është hap mbi bazën e nenit 37 paragrafi 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtaret Publik dhe nenit 10 të Rregullores (KQZ) Nr. 02/2024 për Pranimin e Personelit të Përkohshëm në KQZ, ku arsyeja e plotësimit të kësaj pozite është për angazhimin e personelit të përkohshëm për

zgjedhjen e rregullta për Kuvendin e Kosovës (09.02.2025), ndërsa si kërkesa të përgjithshme formale në këtë konkurs kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve i paspecifikuar, Përvoja:* *Së paku një (1) vit përvojë pune.*

Kolegji i Këshillit në kuptim të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me refuzimin e aplikacionit, ka shqyrtuar dokumentacionit që ankues të bashkangjitur më rastin e aplikimit dhe si rrjedhojë konstatohet si i njëjti ka ofruar Diplomën me Nr. 5679 të datës 10.09.2018, për përfundimin e studime themelore me datë 25.06.2018 në Fakultetin Juridik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, kopjen e ID-së dhe Certifikatën e datës 08.07.2024 të lëshuar nga Sistemi Qendrorë i Evidencës Penale të Kosovës/ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ndërsa, nuk ka dorëzuar dokumentacione tjetër me të cilën do të argumentonte pretendimin ankimor lidhur me përvojën e punës, andaj, mbi këto fakte, rrjedhë së Njësia Përgjegjëse, në këtë rast Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material më rastin e lëshimit të aktit të kontestuar gjegjësisht Njoftimit të datës 14.01.2025, për refuzimin e aplikacionit të ankueses, duke vepruar në pajtim me nenin 15 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 16 të Rregullores (KQZ) Nr. 02/2024 Pranimi i Personelit të Përkohshëm në KQZ, ku përcaktohet: “15. 1. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 1.1. Verifikimi paraprak i kandidatëve; 1.2. vlerësimi profesional i kandidatëve; 16.1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kriteret, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NJMBNJ, më së largu pesë (5) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve ose informatave të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare, që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, NJMBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kriteret për aplikim, që kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme të vlerësimit. 4. Kandidatët të cilët plotësojnë kriteret për aplikim renditen në një listë të ngushtë sipas rendit alfabetik. 5. **Kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin.** Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe aplikantët njoftohen individualisht, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve”.

Andaj, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.133/2025

Avdyl BEKTESHI

Ardita Haxhnikaj DEMI

Procesmbajtës

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit D.K;*
- *Divizionit për Burime Njerëzore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*